

VENDIM
Nr.569, datë 14.7.2010

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM
TË KOMUNËS SURROJ TË QARKUT TË KUKËSIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore, brenda juridiksionit, territorial dhe administrative të komunës Surroj të qarkut të Kukësit, që transferohen në pronësi ose në përdorim të kësaj komune, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista e inventarit me 116 (njëqind e gjashtëmbëdhjetë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 793 (shtatëqind e nëntëdhjetë e tre).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Surroj për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Surroj

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-6,267,271,621	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
9,264,272	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën administrative	Në pronësi
7,270,620	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.	Në pronësi
8,259,273	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive	Në pronësi
11-13,303,304,308-310,625-627	Varrezat publike	Në pronësi
216-246	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
34,35,37,38,40,41,43,392-604	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
36,39,42	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta)	Në pronësi
14-26,262,263,268,269,275	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit	Në pronësi

	ekonomik.	
--	-----------	--